



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-36351 /2023

Klinë, datë 20 / 10 /2023

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 62 pika 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare nr.28/2008, nenin 65 pika 12 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, ne përputhje me autorizimet ligjore, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë:

V E N D I M

*Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë
në Komunën e Klinës*

1. NIKSON DAKA, i lindur më 03.10.1991 më banim në fshatin Pjeterq i Poshtëm Komuna e Klinës, më numër personal të DI 1232447016, **EMËROHET**, Drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Komunën e Klinës.
2. I përmenduri si nga pika 1 e këtij vendimi fillon më ushtrimin e punëve dhe detyrave nga data **20/10/2023**, i cili punët dhe detyrat i kryen sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjeve tjera pozitive, Udhëzimeve si dhe Rregulloreve tjera pozitive komunale si dhe udhëzimeve strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, i cili i raporton rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësin e tij dhe i ofron atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
3. Paga e Drejtorit të Drejtorisë Komunale si dhe të drejtat dhe detyrimet tjera ligjore janë të përcaktuara më akte të veçanta të cilat rregullohen nga Zyra e Personelit sipas ligjit.
4. Obligohet, Drejtoria e Financave- Shërbimi Llogaritar që në bashkëpunim më Zyrën e Personelit t'i kryej të gjitha procedurat lidhur më pagën e të përmendurit si dhe detyrimet tjera ligjore tek organet kompetente.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- I përmenduri;
- Zyra e Personelit;
- Drejtoria e Financave;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

